



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 299/16 Prot.

Tiranë, më 27.01 2023

VENDIM

Nr. 20 dt. 27.01 2023

“PËR  
NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR SHQYRTIMIN E SHKELJES  
DISIPLINORE TË DOC.DR FLORIAN MEMA DHE PROF.ASOC. DR. ABDYL  
KURIU”

Në zbatim të nenit 37 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 68 të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 60 dhe nenit 61 të Statutit të UST-së, si dhe në vijim të Relacionit të Këshillit të Etikës nr.2032/9 prot, datë 16.12.2022 “Për propozimin e masës disiplinore për zgjidhjen e kontratës së punës për Z. Florian Mema dhe Z. Abdyl Kuriu” si dhe Vendimit nr.3 datë 16.12.2022 të Këshillit të Etikës “Për propozimin e masës disiplinore zgjidhjen e kontratës së punës për Z. Abdyl Kuriu” dhe Vendimin nr.4, datë 16.12.2022 të Këshillit të Etikës “Për propozimin e masës disiplinore zgjidhjen e kontratës së punës për Z. Florian Mema”, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 27.01.2023:

VENDOSI:

1. Të ngrejë Komisionin ad hoc për të vazhduar shqyrtimin e shkeljes disiplinore të kryer nga Doc.Dr. Florian Mema dhe Prof.Asoc. Abdyl Kuriu.
2. Komisioni do të ketë këtë përbërje:
  - Prof.Asoc.Dr. Robert Çitozi-kryetar
  - Prof.Asoc.Dr. Juel Jarani-anëtar
  - Prof.Dr. Adriatik Meta-anëtar
3. Të zgjedhë Prof.Asoc.Dr. Robert Çitozi, kryetar të Komisionit ad hoc.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

